



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA E KOSOVOVA / РЕПУБЛИКА КООСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	01 / 1861
Data: Datum: Date:	13.02.23
PRISHTINË / A	
No. 2	

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Environment Spatial Planning and Infrastructure

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 11 nënparagrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr.34/18 nëntor 2022), nenit 10 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, nr 7/01 mars 2019), Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shoferi (Gazeta Zyrtare nr.17/10 qershor 2016), nenit 53 të Ligjit nr.05/L-031 për Proceduren e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare nr.20/21 qershor 2016), nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr.02/2021 për Fushat e Përgjigjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 04/2021 dhe Rregulloren 03/2022, merr:

V E N D I M

I. Anulohet në tërësi procesi i testimit të kandidatëve për licencim të pyetësit teorik, i mbajtur nga MMPHI me datën 02.02.2023.

II. Obligohet Departamenti i Automjeteve që në përputhje me nenin 108 të Ligjit 05/L-031 për Proceduren e Përgjithshme Administrative t'i njoftoj kandidatët për anulimin e provimit si dhe brenda 10 ditëve nga dita e anulimit të provimit të cakton datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit.

III. Kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për t'iu nënshtruar provimit me datën 02.02.2023 janë të liruar nga pagesa e paraqitjes së provimit që do të caktohet sipas pikës 2 të këtij vendimi.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-064 për Patent Shoferi dhe Udhëzimin Administrativ nr. 08/16 për Pyetës, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datën 23.09.2022, ka publikuar në web faqen zyrtar të Ministrisë, njoftimin për aplikim për provimin për licencim të pyetësit teorik, në të cilin ka paraqitur edhe kushtet që duhet të plotësohen nga një person për t'iu nënshtruar provimit.

Me datën 01.02.2023 Ministria ka publikuar njoftimin për mbajtjen e provimit kurse me datën 02.02.2023 ka mbajtur provimin për pyetës teorik.

Pas procesit të testimit MMPHI-ja ka pranuar informaten se çelësi (shablloni) i provimit me pyetje dhe përgjigje, të cilat kanë qenë të përcaktuara edhe në testin teorik që kanë pasur kandidatët gjatë mbajtjes së provimit, është parë i publikuar në opinionin e jashtëm, me këtë rast është konstatuar që ky fakt ka ndikuar drejtëpërdrejt në rrjedhen e rezultatit tek kandidatët të cilët kanë qenë pjesmarrës në provim.

Duke pasë parasysh këtë që u theksua me lartë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues duke u bazuar në Ligjin nr.05/L-031 për Proceduren e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenet 4, 5 8, 53 54 (paragrafi 1.1 dhe 1.3), dhe nenin 55 (paragrafi 1) me qëllim të ruajtjes së ligjshmëris së procesit të testimiti ka vendosur të anuloj në tërësi testimin e bërë me datën 02.02.2023 dhe të kthej në rivlersim kandidatët për pyetës teorik.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të vendimit.



Hysen Durmishi, Zëvendësministër

Vendimi i dërgohet:

- *Ministrit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm MI-së*
- *Departamenti Automjeteve*
- *Divizionit për Komunikim me Publikun*
- *Kandidatëve*
- *Arkivit*